



Datë: 13.06.2025
Numër Protokollit: 4142/2025

A.nr.765/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Atdhe Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.765/2025 të datës 29.04.2025, të parashtruar nga ankuesja F.R, kundër organit të punësimit/Komuna e Klinës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.765/2025, të datës 29.04.2025, të parashtruar nga ankuesja F.R.

A r s y e t i m

Ankuesja, F.R (*më tej referuar vetëm* Ankuesja), kandidate për pranim në shërbimin civil, sipas konkursit me numër Reference RN00016714, të shpallur më datë 13.02.2025, nga Komuna e Klinës, për pozitën e punës *Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore*, në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, më datë 29.04.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2829/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.765 /2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit për rezultatin përfundimtar me numër protokollit 02Nr.111-9687/25 të datës 07.04.2025.

Tutje, ankuesja më datë 28.05.2025, përmes shkresës me numër protokollit 3571/025, për arsye personale është tërhequr nga ankesa me numër A.nr.765/2025 e datës 29.04.2025.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 28.05.2025, të ankueses për tërheqje nga ankesa A.nr.765/2025, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”*, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.765/2025 të datës 29.04.2025, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.765/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.R;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Klinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.